



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEĆA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-06/IA036
KSC-BC-2020-06/IA037
KSC-BC-2020-06/IA038
KSC-BC-2020-06/IA039

Vendosi: Kryetarja e Dhomave të Specializuara
Gjykatëse Ekaterina Trendafilova

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 4 korrik 2025

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Vendim për Caktimin e Panelit të Gjykatës së Apelit

Gjykatësve të Panelit të Gjykatës së Apelit:

Gjykatëse Mishelë Pikar

Gjykatës Kai Ambos

Gjykatëse Nina Jorgensen

Mbrojtjes së Hashim Thaçit:

Luka Mishetiç

Mbrojtjes së Kadri Veselit:

Rodni Dikson

Prokurores së Specializuar

Kimberli P. Uest

Mbrojtjes së Rexhep Selimit:

Xhefri Roberts

Mbrojtjes së viktimave:

Sajmon Loz

Mbrojtjes së Jakup Krasniçit:

Venkatesvari Alagenda

KRYETARJA e Dhomave të Specializuara ("Kryetarja"), duke vepruar në bazë të neneve 33(1)(c) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar, rregullave 77, 82(4), 169 dhe 170(2) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës ("Rregullorja") dhe rregullave 3 dhe 4 të Rregullores për Caktimin e Gjykatësve të Dhomave të Specializuara nga Regjistri i Gjykatësve Ndërkombëtarë ("Rregullorja për Caktimin e Gjykatësve"), me anë të këtij vendimi cakton një Panel të Gjykatës së Apelit pas lëshimit nga Trupi Gjykues II të Vendimit mbi Kërkesën e Përbashkët të Mbrojtjes për Leje për Apelim të Vendimit mbi Pranimin e Dëshmisë si Ekspert të Dëshmitarit W04875 ("Vendimi i Parë për Miratim të Lejes për Apelim"),¹ Vendimit mbi Kërkesën Përmbledhëse të Mbrojtjes për Apelim të Vendimeve mbi Pranimin e Dëshmive si Ekspertë të Dëshmitarëve W04826 dhe W04874 (F03201 dhe F03203)("Vendimi i Dytë për Miratimin e Lejes për Apelim"),² Vendimit mbi Kërkesën e Përbashkët të Mbrojtjes për Apelim të Vendimit mbi Mocionin e Prokurorisë për Pranimin e Dokumenteve lidhur me Viktimën e Vrasjes së Paligjshme dhe Kërkesën Përkatëse ("Vendimi i Tretë për Miratim të Lejes për Apelim"),³ dhe Vendimit mbi Kërkesën e Përbashkët të Mbrojtjes për Leje për Apelim të Mocionit të ZPS-së për Pranimin e Provave të W04747-ës sipas Rregullës 155 ("Vendimi i Katërt për Miratim të Lejes për Apelim"), bashkërisht Vendimet për Miratimin e Lejes për Apelim.⁴

¹ F03297, Vendim mbi Kërkesën e Përbashkët të Mbrojtjes për Leje për Apelim të Vendimit mbi Pranimin e Dëshmisë së Dëshmitarit Ekspert W04875, 1 korrik 2025 (Publik).

² F03298, Vendim mbi Kërkesën e Përbashkët Përmbledhëse të Mbrojtjes për Leje për Apelim të Vendimit mbi Pranimin e Dëshmive si Ekspertë të Dëshmitarëve W04826 dhe W04874, (F03201 dhe F03203), 1 korrik 2025 (Publik).

³ F03299, Vendim mbi Kërkesën e Përbashkët të Mbrojtjes për Leje për Apelim të Vendimit mbi Mocionin e Prokurorisë për Pranimin e Dokumenteve lidhur me Viktimat e Vrasjes së Paligjshme dhe Kërkesën Përkatëse, 1 korrik 2025 (Publik).

⁴ F03300, Vendim mbi Kërkesën e Përbashkët të Mbrojtjes për Leje për Apelim të Vendimit mbi Mocionin e ZPS-së për Pranimin e Provave të W04747-ës sipas Rregullës 155, 1 korrik 2025, (konfidencial).

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 27 maj 2025, Trupi Gjykses II lëshoi Vendimin mbi Pranimin e Dëshmisë si Ekspert të Dëshmitarit W04875, ⁵Vendimin mbi Pranimin e Dëshmisë si Ekspert të Dëshmitarit W04826 ("F03201"), ⁶ dhe Vendimin mbi Pranimin e Dëshmisë si Ekspert të W04874-ës ("F03203").⁷

2. Më 29 maj 2025, Trupi Gjykses II lëshoi Vendimin mbi Mocionin e Prokurorisë për Pranimin e Dokumenteve lidhur me Viktimat e Vrasjes së Paligjshme dhe Kërkesën Përkatëse. ⁸

3. Më 3 qershor 2025, Mbrojtja e Hashim Thaçit ("z. Thaçi"), Kadri Veselit ("z. Veseli"), Rexhep Selimit ("z. Selimi"), dhe Jakup Krasniqit ("z. Krasniqi") dorëzuan Kërkesën e Përbashkët të Mbrojtjes për Leje për Apelim të Pranimin të Dëshmisë si Ekspert të Dëshmitarit W04875 (F03202)" ⁹ dhe Kërkesën Përmbledhëse të Përbashkët të Mbrojtjes për Leje për Apelim të Vendimeve mbi Pranimin e Dëshmise si Ekspertë të Dëshmitarëve W04826 dhe W04874 (F03201 dhe F03203)".¹⁰

4. Më 5 qershor 2025, Mbrojtja e zotërinjëve Thaçi, Veseli, Selimi dhe Krasniqi dorëzuan Kërkesën e Përbashkët të Mbrojtjes për Leje për Apelim të Vendimit mbi Mocionin e Prokurorisë për Pranimin e Dokumenteve lidhur me Viktimat e Vrasjes së

⁵ F03202, Vendim mbi Pranimin e Dëshmisë si Ekspert të Dëshmitarit W04875, 27 maj 2025 (Publik).

⁶ F03201, Vendim mbi Pranimin e Dëshmisë si Ekspert të W04826-ës, ("F03201"), 27 maj 2025 (Publik).
Versioni i korrigjuar u dorëzua më 16 qershor 2025, F03201/COR.

⁷ F03203, Vendim mbi Pranimin e Dëshmisë si Ekspert të W04874-ës ("F03203"), 27 maj 2025 (Publik).

⁸ F03211, Vendim mbi Mocionin e Prokurorisë për Pranimin e Dokumenteve lidhur me Viktimat e Vrasjes së Paligjshme dhe Kërkesën Përkatëse, 29 maj 2025 (konfidencial).

⁹ F03222, Kërkesë e Përbashkët e Mbrojtjes për Leje për Apelim të Vendimit mbi Pranimin e Dëshmisë si Ekspert të Dëshmitarit W04875 (F03202), 3 qershor 2025 (konfidenciale). Versioni i redaktuar publik u dorëzua më 30 qershor 2025, F03222/RED.

¹⁰ F03222, Kërkesë e Përbashkët e Mbrojtjes për Leje për Apelim të Vendimit mbi Pranimin e Dëshmisë si Ekspert të Dëshmitarit W04826 (F03201), 3 qershor 2025 (konfidenciale). Versioni i redaktuar publik u dorëzua më 30 qershor 2025, F03222/RED.

Paligjshme dhe Kërkesën Përkatëse (F03211)",¹¹ dhe Kërkesën e Përbashkët të Mbrojtjes për Leje për Apelim të Vendimit mbi Mocionin e ZPS-së për Pranimin e Provave të W04747-ës sipas Rregullës 155.¹²

5. Më 1 korrik 2025, Trupi Gjykses lëshoi Vendimin e Parë për Leje për Apelim, Vendimin e Dytë për Leje për Apelim, Vendimin e Tretë për Leje për Apelim dhe Vendimin e Katërt për Leje për Apelim ku, ndër të tjera, miratoi pjesërisht kërkesat e Mbrojtjes.¹³

II. CAKTIMI

6. Pas shqyrtimit të kriterëve të përcaktuara në rregullën 4 të Rregullores për Caktimin e Gjykatësve, duke përfshirë përvojën dhe kompetencën përkatëse, si edhe disponueshmërinë e gjykatësve në këtë moment,

¹¹ F03238, Kërkesë e Përbashkët e Mbrojtjes për Leje për Apelim të Vendimit mbi Mocionin e Prokurorisë për Pranimin e Dokumenteve lidhur me Viktimën e Vrasjes së Paligjshme dhe Kërkesën Përkatëse (F03211), 5 qershor 2025 (konfidenciale).

¹² F03239, Kërkesë e Përbashkët të Mbrojtjes për Leje për Apelim të Vendimit mbi Mocionin e ZPS-së për Pranimin e Provave të W04747-ës sipas Rregullës 155, 5 qershor 2025 (konfidenciale).

¹³ F03297, Vendimi i Parë për Leje për Apelim, para. 49; Vendimi i Dytë për Leje për Apelim, f. 17; Vendimi i Tretë për Leje për Apelim, para. 28 Vendimi i Katërt për Miratimin e Lejes për Apel, para. 57.

